

Terma Reference

Thirrje për ekspert/grup ekspertësh për vlerësimin e fëmijëve rezidentë në Shtëpinë e Fëmijës 0-5 vjeç Korçë dhe Vlorë dhe familjeve të tyre

| | |
|---------------------------------|---|
| Konsulenca | Ekspert/Grup ekspertësh për vlerësimin e fëmijëve rezidentë në Shtëpinë e Fëmijës 0-5 vjeç Korçë dhe Vlorë dhe familjeve të tyre |
| Projekti | “Përgjigje ndaj rrezikut të shtuar të abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe ndarjes nga familja” zbatuar në partneritet me UNICEF (ALB/PCA202213/PD202359) |
| Kohëzgjatja e shërbimit | Maj-Qershor 2023 |
| Lloji i kontratës | Kontratë Shërbimi |
| Data e fillimit të punës | 25 Maj 2023 |

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të kontraktojë një **ekspert ose grup ekspertësh për kryerjen e vlerësimit të fëmijëve që janë të akomoduar pranë Shtëpisë së Fëmijës 0-5 vjeç në Korçë dhe Vlorë dhe familjeve të tyre biologjike**, në kuadër të projektit “Përgjigje ndaj rrezikut të shtuar të abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe ndarjes nga familja” zbatuar në partneritet me UNICEF dhe financuar nga Qeveria Suedeze. Kjo ekspertizë do të ofrohet në mbështetje të grupit të punës të ngritur pranë MSHMS për vlerësimin e fëmijëve, familjeve si dhe hartimin e planeve për mundësitë dhe alternativat për përkujdesin e tyre në kuadër të planit të transformimit për institucionet e përkujdesit shoqëror në Shqipëri-Pilot Bashkia Korçë dhe Vlorë.

Të dy Institucionet e përkujdesit shoqëror për grup-moshën e fëmijëve 0-5 vjeç në Bashkitë Korçë dhe Vlorë, të cilat në bazë të VKM nr.706, dt.09.09.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit (PKD), 2020-2022, dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e tij”, Objektivi 2 strategjik, janë 2 institucionet e para të vendosura në moratorium dhe në fazë pilotimi të transformimit të shërbimeve.

Informacion i Përgjithshëm:

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimeisht NISMA) është një organizatë jofitimprurëse, e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. NISMA është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i NISMA është të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për individë dhe grupet më të marginalizuara në shoqërinë shqiptare me theks të veçantë në komunitetet Rome dhe Egjiptiane. NISMA advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

Përshkrim i projektit:

Projekti ka si qëllim të ofrojë dhe sigurojë mbështetje për sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe të ofrojë shërbime mbështetëse të integruara për fëmijët dhe familjet në nevojë dhe në nivel të lartë vulnerabiliteti nga abuzimi, shfrytëzimi dhe trafikimi. Projekti fokusohet jo vetëm në mbështetje për fuqizimin e familjeve dhe fëmijëve, por edhe pilotimin e shërbimeve të reja mbështetëse për fëmijën dhe familjen, familjet kujdestare profesionale si dhe ngritja e kapaciteteve për punonjësit që janë pjesë e ofrimit të shërbimeve dhe kujdesit social në kuadër të avancimit të procesit të deinstitutionalizimit.

Grupet përfituese dhe aktorët kyç:

- Prindër/ kujdestarë të identifikuar në nevojë për mbrojtje ose në nevojë për referim në shërbimet e kujdesit social;
- Fëmijë të vlerësuar në risk të mesëm ose të lartë ndaj shfrytëzimit, dhunës apo abuzimit;
- Fëmijë të vendosur në shërbimet e përkujdesit shoqëror rezidencial;
- Familje me fëmijë në risk për tu institucionalizuar;
- Punonjës të strukturave vendore, përgjegjës për mirëqenien e fëmijëve;
- Punonjës të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.

Detyrat dhe përgjegjësitë për secilin ekspert:

Loti 1-Ekspert psikolog-terapist zhvillimi:

Psikologu/terapisti i zhvillimit, ka si detyrë të asistojë me ekspertizën tij/saj grupet e punës të ngritura në secilën Bashki Korçë dhe Vlorë me qëllim realizimin e vlerësimit të fëmijëve në institucionin e përkujdesit për fëmijë Shtëpia e Foshnjës Vlorë dhe Shtëpia e Foshnjës „Lulet e Vogla“ Korçë, familjet e tyre si dhe hartimin e planeve për mundësitë dhe alternativat për përkujdesin e tyre.

- Të zbatojë metodologjinë e vlerësimit të fëmijës dhe familjes së ndjekur në fazën e parë dhe të dytë të zbatimit të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit për secilin fëmijë sipas :
 - o Formularit të vlerësimit të fëmijës
 - o Formularit të vlerësimit të familjes
 - o Planit individual të zhvillimit të fëmijës
 - o Planit individual të deinstitutionalizimit të fëmijës dhe fuqizimit të familjes biologjike ose alternativave të tjera me bazë familjen.
- Të vlerësojë anën zhvillimore të fëmijëve nëpërmjet vëzhgimit në mjedisin ku ndodhen duke vlerësuar aftësitë psiko-motorike, ndërveprimin emocional dhe social, zhvillimin kognitiv dhe gjuhësor, sipas piketave të zhvillimit, terapisë së lojës/terapia e artit dhe instrumentave të certifikuar.
- Të vlerësojë anën psikologjike të prindërve biologjike dhe kapaciteteve të prindërimit.
- Të dokumentojë procesin e vlerësimit të fëmijëve dhe familjeve në dosjet përkatëse
- Të mbështesë grupin e punës në hartimin e raportit mbi procesin e vlerësimit në përputhje me termat e referencës së grupit të punës.

Profili i ekspertit psikolog/terapist zhvillimi:

I. Kualifikime

- Diplomë universitare/pasuniversitare në psikologji.
- Të ketë ndjekur trajnime kualifikuese shpesh në psikoterapi, terapinë e zhvillimit, këshillimit.

- Të jetë i licensuar për ushtrimin e profesionit
- Të jetë e/i çertifikuar për ofrimin për vlerësimin dhe ofrimin e shërbimeve psikologjike.

II. Eksperienca e punës

- Të ketë jo më pak se 5 vite eksperiencë pune në ushtrimin e profesionit të tij/saj në qendra që ofrojnë shërbime të specializuara psikologjike për fëmijët.
- Të ketë eksperiencë pune në ekip multidisiplinar për vlerësim dhe ngritje e plani të zhvillimit/trajtimit.
- Njohuri shumë të mira në gjuhën angleze në formën e shkruar dhe të folur;
- Mundësi dhe dëshirë për të lëvizur në terren;
- Aftësi shumë të mira në arritjen e afateve;
- Aftësi shumë të mira në komunikim, dhe menaxhim të situatave;
- Aftësi për të punuar në presion kohe, në punë në grup dhe në mënyrë të pavarur.

Loti 2- Eksperti punonjës social/menaxher rasti, pritet të:

Punonjësi social/menaxher rasti ka si detyrë të asistojë me ekspertizën tij/saj grupet e punës të ngritura në secilën Bashki Korçë dhe Vlorë me qëllim realizimin e vlerësimit të fëmijëve në institucionin e përkujdesit për fëmijë Shtëpia e Foshnjes Vlorë dhe Shtëpia e Foshnjes „Lulet e Vogla“ Korçë, familjet e tyre si dhe hartimin e planeve për mundësitë dhe alternativat për përkujdesin e tyre.

- Të zbatojë metodologjinë e vlerësimit të fëmijës dhe familjes së ndjekur në fazën e parë dhe të dytë të zbatimit të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit për secilin fëmijë sipas :
 - Formularit të vlerësimit të fëmijës
 - Formularit të vlerësimit të familjes
 - Planit individual të zhvillimit të fëmijës
 - Planit individual të deinstitutionalizimit të fëmijës dhe fuqizimit të familjes biologjike ose alternativave të tjera me bazë familjen.
- Vlerësimi përfshin rishikimin e dokumenteve dhe të dhënave të përgjithshme për fëmijët nga IPSH, SHSSH, NJMF dhe palë të tjera të interesuara në kontakt me fëmijët dhe familjet e tyre duke identifikuar shkaqet e ndarjes së fëmijës nga familja dhe mënyrën e trajtimit të tyre.
- Të vlerësojë dimensionet e familjes në të gjithë komponentët e saj, të analizojë potencialin e fuqizimit të prindërimit dhe fuqizimit ekonomik
- Të dokumentojë procesin e vlerësimit të fëmijëve dhe familjeve në dosjet përkatëse
- Të kontribuojë në hartimin e raportit mbi procesin e vlerësimit në përputhje me termat e referencës së grupit të punës.

Profili i punonjës social- menaxher rasti:

I. Kualifikime

- Diplomë universitare/pas universitare në punë sociale
- Të ketë ndjekur trajnime kualifikuese shtesë në fushën vlerësimi të familjes dhe menaxhimit të rastit
- Të jetë i licensuar për ushtrimin e profesionit

II. Eksperienca e punës

- Të ketë jo më pak se 5 vite eksperiencë pune në fushën e vlerësimit të familjes dhe menaxhimit të rasisit
- Të jetë njohës shumë i mirë i legjislacionit të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve
- Të jetë njohës shumë i mirë i sistemit të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale
- Të ketë njohuri shumë të mira në fushën e deinstitutionalizimit
- Të ketë eksperiencë pune në ekip multidisiplinar për vlerësim dhe zhvillim plani fuqizimi.
- Njohuri shumë të mira në gjuhën angleze në formën e shkruar dhe të folur;
- Mundësi dhe dëshirë për të lëvizur në terren;
- Aftësi shumë të mira në arritjen e afateve;
- Aftësi shumë të mira në komunikim, dhe menaxhim të situatave;
- Aftësi për të punuar në presion kohe, në punë në grup dhe në mënyrë të pavarur.

Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve: Të gjithë personat që punojnë me programet e NISMA janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, kodin e sjelljes të NISMA ARSIS.

Koha e mundshme e fillimit të punës është 25 maj 2023

Kohëzgjatja e ofrimit të shërbimit është përgjatë periudhës maj-qershor 2023

Kjo ekspertizë përfshin 10 ditë pune në ekip (5 ditë për punonjësin social dhe 5 ditë për psikologun).

Procedura e Aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për secilin nga pozicionet e sipër shënuara duhet të dërgojnë me email

- 1- CV-në;
- 2- Letër interesi;
- 3- Letër angazhimi/disponueshmërie;
- 4- Ofertën financiare;
- 5- Taksa e regjistrimit (nëse disponohet).

në adresën e emailit: initiative.arsis@gmail.com deri në datën **23 Maj 2023**, mesnatë.

Në vemendjen tuaj që në subjekt të emailit ku dërgohet aplikimi të vendoset: Aplikim për pozicionin e ekspertit në vlerësimin e fëmijëve në IPSH dhe familjeve të tyre - (sipas profilit që do të aplikoni).

Procedura e Vlerësimit:

Zgjedhja e ekspertit/grupit të ekspertëve do të bazohet në: se sa mirë aplikimi përmbush kërkesat e përcaktuara në termat e referencës, gjithashtu edhe bazuar në tabelën e vlerësimit të mëposhtëm.

| Kriteret e vlerësimit | Vlerat në % |
|------------------------------|--------------------|
| Kualifikime | 30% |
| Eksperiencë pune | 50% |
| Oferta financiare | 20% |

Ju lutem konsideroni që vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë do të kontaktohen.